# A K T - T H E M E L I M I

## PER SHOQERIN ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR " N E R I " BALLSH

Ne mbeshtetje te ligjeve Nr.7632 date 4.11.1992 dhe 7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregotare",une Gezim Melasi i biri i Namikut dhe i Soses,i dtl. 21.2.1961,lindur e banues ne Ballsh shtetas shqiptar,vendosa te krijoj shoqerin me pergjegjesi te kufizuar me kushtet e me poshteme:

Neni 1

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar e krijuar prej meje do te emertohet "SHOQERIA ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR " N E R I " BALLSH ".

Ajo do te njihet edhe me emertimin e shkurtuar :" SH.P.K." N E R I " Ballsh"

Neni 2

SH.P.K." N E R I " qendren dhe selin e saj do ti kete ne qytetin e Ballshit ne afersi te Bashkise Ballsh.Aktiviteti i saj do te shtrihet sipas leverdise ekonomike te saj edhe ne rrethe te ndryshme te vendit dhe jashte shtetit ne import eksport.

Neni 3

Kjo shoqeri krijohet me mjetet vetjake te ortakut te vetem qe eshte themeluesi i saj,i cili merr persiper te gjitha detyrimet e tjera ligjore per te.

Neni 4

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar " N E R I " do te kete statusin e personit juridik shqiptar.Gjithe aktiviteti i saj do te jete ne perputhje me ligjin shqiptar dhe ne rastet kur ajo do te kryej veprime ne vende te tjera te botes ,kjo veprimtari do te jete ne perputhje edhe me legjislacionin e vendit perkates ku do te kryej veprime juridike.

Neni 5

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar " N E R I " SH.P.K.do te kete si objekt te aktivitetit:

Tregetimi me shumice e pakice,brenda dhe jashte shtetit i mallrave te ndryshme ushqimore dhe industriale,materialesh ndertimi,bimesh medicinale,produkte bujqesore,karburante si dhe nenprodukte te tjera te naftes si vajguri,solar koks,gaz natyror,vajra lubrifikante,makina e makineri te ndryshme dhe pjese kembimi per to,trasporte te ndryshme mallrash dhe udhetaresh brenda dhe jashte shtetit,sherbim hoteleri dhe turizmi.

Neni 6

Kapitali themeltar i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar " N E R I " eshte 100 000 leke te reja te depozituara ne banke.

Neni 7

" N E R I " SH.P.K.krijohet per te vazhduar aktivitetin e saj per nje afat mbi 10 vjet.

Neni 8

Organi i vetem drejtues dhe administrues i shoqerise eshte orteku i vetem dhe themeluesi i saj,qe do te njihet si administrator i saj.

Neni 9

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar " N E R I " pergjigjet per detyrimet e saj ndaj cilitdo kreditori deri ne nivelin e plot te mjeteve te saj.

Neni 10

Per zhvillimin e metejshem te SH.P.K. dhe rregullimin e te gjitha marredhenieve te tjera,do te hartohet edhe statuti i shoqerise qe do ti bashkelidhet aktit te themelimit.

THEMELUESI I SH.P.K." N E R I "

Gezim Malasi

Gezim Malaesi

G.Malasi

REPUBLIKA E SHQIPERISE

ZYRA E NOTERISE

Nr. 2685

V E R T E T I M

Sot me daten 29.10.1997 para meje noterit Ilir Dushi u paraqit personalisht Z.Gezim Malasi i biri i Namikut dhe i Soses,i dtl.21.2.1961,lindur e banues ne Ballsh,me zotsi te plot juridike per te vepruar, i njohur me leternjoftimin personal,i cili deklaroi se ka nenshkruar me vullnet te lire kete akt themelimi te SH.P.K." N E R I " dhe une e vertetoj rregullisht.

N O T E R I

ILIR DUSHI

PULLE TAKSE

50 LEKE

R.SHQIPERISE

# S T A T U T

## I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR " N E R I "

Ne mbeshtetje te ligjeve Nr.7632 date 4.11.1992 dhe 7638 date 19.11.1992 " Per shoqerite tregtare dhe ne baze te aktit te themelimit,une Gezim Malasi i biri i Namikut dhe i Soses,i dtl.21.2.1961,lindur e banues ne Ballsh,krijova shoqerin me pergjegjesi te kufizuar " N E R I " per aktivitetin ne vashdim te ɇe ciles njorr kete statut.

### DISPOZITA TE PERGJITHSHME

Neni 1

Shoqeria private me pergjegjesi te kufizuar " N E R I " krijohet nga ortaku i vetem qe eshte edhe themelues i saj me mjetet vetjake te tij.

Neni 2

Selia dhe qendra e kesaj shoqerie private do te jone ne qytetin e Ballshit lagja "5 Shkurti".

Kjo seli mund te ndryshohet sipas kushteve qe do te lindin me vendim te administratorit te shoqerise.

Neni 3

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar do te emertohet " N E R I " Sh.P.K.

Shoqeria do te kete edhe mertimin e shkurtuar : "SH.P.K." N E R I " Ballsh.

Neni 4

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar do te kete ne vulen e saj inicialet SH.P.K. " N E R I " eksp.import A L B A N I A!

Neni 5

" Neri " Sh.p.k. do te kete statusin e personit juridik shqiptar.Aktiviteti i kesaj shoqerie do te behet ne perputhje me legjislacionin shqiptar per rastet kur ajo do te veproj brenda vendit,kurse ne rastet kur kjo shoqeri do te hyje ne marrdhenie juridike me persona fizik e juridik te jashtem,aktiviteti i saj do te jete edhe konforem legjislacionit te shtetit ku ajo do te kryej keto veprime juridi ke.

Neni 6

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar " N E R I " SH.P.K. do te kete ne objektin e veprimtarise se saj: "Tregetimi me shumice e pakice brenda dhe jashte shtetit i mallrave te ndryshme ushqimore dhe industriale,materialesh ndertimi, bimesh medicinale,produkte bujqesore,karburante si dhe nenprodukte te tjere te naftes si vajguri,solar,koks,gaz natyror,vajra lubrifikante,makina e makineri te ndryshme dhe pjese kembimi per to,trasporte te ndryshme mallrash dhe udhetaresh brenda dhe jashte shtetit,sherbim hotelori dhe turizmi.

G.Malasi

Neni 7

Kjo shoqeri do te ushtroj aktivitetin e saj ne qytetin e Ballshit dhe ne rrethe te tjera brenda vendit si dhe jashte shtetit sipas leverdise ekonomike qe do te kete ajo.

Neni 8

Mjetet e shoqerise ne vazhdim te aktivitetit te saj mund te shtohen e pakesohen vetem me vendim te administratorit te shoqerise, i cili sipas rastit vendos edhe per shtimin ose pakesimin e veprimtarise sipas objektit te saj.

MJETET E SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

Neni 9

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar " N E R I " e fillon aktivitetin e saj mbi bazen e nje kapitali themeltar prej 100 000 lekesh. Ajo ka ne pronesi te saj edhe kushtet e tjera te nevojshme si dhe nje pike shperndarje karburanti qe jane plotsisht te mjaftueshme per fillimin dhe vazhdimin e aktivitetit te saj.

Neni 10

Ne mjetet e shoqerise do te futen ne te ardhmen edhe objektet e tjera dhe sende e te holla qe do te fitohen nga ajo nepermjet aktivitetit te ligjshem ne perputhje me kete statut dhe legjislacionin ne fuqi.

Neni 11

Per detyrimet e veta si ndaj shtetit ashtu edhe ndaj te treteve me te cilet kjo shoqeri do te hyje ne marrdhenie juridike dhe do te kete detyrime te ndersjellta, ajo pergjigjet deri ne nivelin e plot te mjeteve te saj.

Neni 12

Ne rast shperberje te SH.P.K. per arsye te ndryshme mjetet e saj do te ndahen sipas kontratave perkatse qe mund te lidhen ne vone ku do te percaktohet edhe forma perkatse e shlyerjes se detyrimeve te saj ndaj kreditoreve.

Neni 13

SH.P.K." N E R I " do te kete fondin e saj rezerve te perbere sipas dispozites urdheruese te ligjit prej 1/20 pjese te fitimit te vitit te mepareshem financiar.

Me qellim qe te sigurohen plotsisht kreditimet e te treteve me vendim te administratorit kjo pjese e rezerves mund te rritet sipas kushteve te me vonshme qe do ti lindin asaj.

Neni 14

Fondi rezerve i SH.P.K. do te jete i pacenueshem dhe do te disponohet nga ana e administratorit vetem ne raste te vecanta per te perballuar veshtiresi te ndryshme qe mund ti lindin SH.P.K.-se.

ORGANET DREJTUESE TE SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

Neni 15

Organet drejtuese te SH.P.K."N E R I " do te jene:

Gjallasi

1.Administratori i SH.P.K.se,qe eshte njekohesisht edhe themeluesi i saj.

2.Ne se ne te ardhmen do te aderojne edhe ortak te tjere,organi drejtues do te jete mbledhja e ortakeve (Asambleja).

Neni 16

Administratori eshte organi me i larte vendimor dhe ekzekutive i SH.P.K! " M E R I ".

Administrator i kesaj shoqerie eshte Z.Gezim Malasi.

Neni 17

Administratori marrdheniet e tij me administraten dhe te punesuarit ne kete shoqeri i rregullen edhe ne baze te ligjeve te tjera te punes,te sindikatave apo akteve te tjera ligjore e nenligjore sipas rastit.

Neni 18

Administratori kryen gjate gjithe kohes funksionin e tij per organizimin dhe drejtimin e gjithe aktivitetit te SH.P.K.

Administratori nuk mund te shkarkohet nga detyra e tij per cfardo arsye qofte,pervec rasteve te parashikuara ne ligj.

Neni 19

Administratori ka keto kopetenca:

1.Organizon dhe drejton gjithe veprimtarin e shoqerise dhe nxjerrjen e saj me fitime.

2.Perfaqeson SH.P.K.ne ndaj personave te trete,personave fizik apo juridik me shtetin dhe antareve te tjere te kesaj shoqerie qe jane punesuar ne te apo lidhen me te forma te tjera te ndryshme.

3.Vendos per hapjen e sektoreve te rinje apo njesi te tjera organisative

4.Emeron dhe shkarkon pergjegjesat apo shefat e ndryshem qe vendosen ne baze te nevojave dhe menyres se organizimit te punes ne kete shoqeri.

5.Percakton dhe emeron punonjesit e administrates te cileve ju percakton edhe punen konkrete qe do te kryejne,duke patur parasysh kualifikimin e profesion

6.Vendos per fondin e pergjithshem te pagave dhe bene ndarjen konkrete te pagave te punes per secilin funksion,shperblimet qe mund te jepen sipas rastit, dhe masa e ketyre shperblimeve qe do te jepen konkretisht.

7.Vendos per ndryshimin e formes se organizimit,drejtimit te punes,pushimin e aktivitetit te shoqerise dhe shperbarjen e saj,kalimin e saj ne likujdim et

8.Percakton eksportin kontabel dhe kerkon bilancin vjetor apo statistika te tjera per te pare ecueshmerin ne vazhdimesi te aktivitetit per ti shpetuar thellimit te humbjeve nga cilido faktor qofshin ato.

20

Vula e shoqerise vendoset vetem per te vertetuar nenshkrimin e administratorit.

21

GMalasi

Neni 21

Ne rastet kur administratori do te largohet per shkage te ndryshme, te drejton e nenshkrimit te vertetuar me vulle do ta kete personi qe do ta zevendesoje ate, i autorizuar me shkrim.

Neni 22

Ne rastet e vdekjes se administratorit vendin e tij e ze personi i percaktuar prej tij me shkrim dhe ne baze te ligjit. Ne rast te kundert shoqeria shperbehet dhe kalon ne likujdim, duke ju kaluar te gjitha te drejtat e detyrimet trashegimtareve ligjor te tij.

MENYRA DHE KUSHTET E NDARJES SE FITIMIT

Neni 23

SH.P.K." N E R I " perballon te gjithe detyrimet me te ardhurat e saj. Ne keto detyrime do te futen taksat, tatimet, shpenzimet e ndryshme, firot legale e humbje te tjera. Pjesa e mbetur mbas zbritjes se te gjitha ketyre detyrimeve do t jete fitimi neto i SH.P.K.

Neni 24

Nga fitimi qe sigurohet me vendim te administratorit mund te jepen edhe stimuj te ndryshem, shperblime sipas rastit, te behen sponsolizime, te jepet ndihma personave te trete sipas deshires se tij etj.

Neni 25

Per personat e tjere qe mund te aderojne ne kete shoqeri gjate vazhdimit te aktivitetit menyra e ndarjes se fitimeve do te percaktohet ne kontratat perkatse qe do te lidhen me ta, ku do te percaktohen edhe menyrat konkrete te kopetimit dhe bashkepunimit.

Neni 26

Me vendim te administratorit nje pjese e fitimit mund te investohet ne kapitelin themelor per permiresimit e kushteve teknike dhe te punes, investime ne kapitalin variabel etj.

Neni 27

Nga fitimi i realizuar mund te investohet edhe ne persona te tjere fizik apo juridik, vendas dhe te huaj, te blihen aksione, apo te bashkepunohet ne forma te ndryshme me shoqeri te tjera te cfardollojI qofshin ato, qe kryejne nje aktivitet te ligjshem.

ORGANIZIMI I PERDITSHEM I PUNES NE SH.P.K." N E R I

Neni 28

SH.P.K." N E R I " sipas nevojave qe do ti lindin ne te ardhmen me vendim te administratorit mund te hape edhe sektor te tjere apo njesi me te vogla (filiale), te cilat do te veprojne si pjese perberse te saj, pa status te vecant.

G. Malasi

Neni 29

Ne njesi apo reparte do te drejtojne shefat,apo pergjegjesat sipas rastit te cilet emerohen apo shkarkohen nga administratori qe percakton edhe kushtet e tjera per ta, si profesionin ,arsin ,specialitetin,te drejtat e detyrimet per secilin.

Neni 30

Sektor apo filiale mund te hapen edhe ne rrethe te tjera sipas interesave qe do te lindin dhe efektivitetit te aktivitetit te kesaj veprimtarie tregetare.

MARREDHENIET E PUNES NE SH.P.K. " N E R I "

Neni 31

Ne se shoqeria do te kete interes,me vendim te administratorit mund te aderoje ne te edhe persona te tjere,qe do te pranojne te shkrijne apo bashkojne kapitalet e tyre ne kete shoqeri.

Aderimi do te behet ne baze te kushteve te vecanta qe do te percaktohen per secilin ne kontratat e vecanta.

Neni 32

Personi qe do te bashkoje kapitalet me ato te shoqerise "N E R I " nuk ka te drejte ta marre ate fizikisht,ne se ndarja e tij eshte e pamundur,apo demton interesat e kesaj shoqerie.

Ortaku qe vendos te shkeputet dhe te ndahet gezon te drejten e marrjes se vleftes se kapitalit ne rastet e percaktuara me siper,sipas percaktimit,qe do te behet detyrimisht ne kontraten perkatese te bashkimit (aderimit).

Neni 33

Per tu larguar nga shoqeria personat aderues duhet te njoftojne te pakten 3 muaj me shkrim administratorin,para largimit dhe me kalimin e ketij afati kontrata quhet e zgjidhur dhe palet detyrohen te plotsojne detyrimet e percaktuara ne kontrate ndaj njera tjetres.

KOHEZGJATJA DHE MBYLLJA E SH.P.K.

Neni 34

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar krijohet per te ushtruar aktivitetin e saj per nje afat mbi 10 vjet pandererprerje.

Neni 35

Kohezgjatja e aktivitetit te SH.P.K.do te percaktohet nga ecuria e aktivitetit te saj dhe nevojat qe do te paraqesin personat e trete qofshin ata fizik e juridik per sherbimet qe ajo do te kryej,nga qendrueshmeria e kapitalit themelor, leverdia ekonomike etj.

Neni 36

SH.P.K." N E R I " do te mbyllet ne keto raste:

1.Kur aktiviteti i saj bie ndesh me ligjin.

2.Kur shikohet se po shkon drejt falimentimit dhe nuk gjendon rruge per

ndjerrjen e saj me fitime.

3. Hapet ndaj saj procedura e likujdimit.

Neni 37

Kur hapet ndaj shoqerise procedura e likujdimit dhe perfundon me humbje administratori bene shlyerjen e llogarive sipas detyrimeve me kapitalin rezerve dhe kapitalin themelor.

<u>DISPOZITA TE FUNDIT</u>

Neni 38

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar " K E N I " e fiton zotesin e saj per te vepruar me rregjistrimin ne gjykaten e rrethit Tirane,ku do te depozitohet edhe nje kopje e ketij statuti dhe aktit te themelimit.

THEMELUESI I SHOQERISE

GEZIM MALASI

Gezim Malasi

GMalasi

REPUBLIKA E SHQIPERISE

ZYRA E NOTERISE

Nr. 2684 i Rrezit

<u>V E R T E T I M</u>

Sot me daten 24.10.1997 para meje noterit Ilir Dushi u paraqit personalisht Z.Gezim Malasi i biri i Namikut dhe i Soses,i dtl.21.2.19961,lindur e banues ne qytetin e Ballshit,me zotsi te plot juridike per te vepruar, i njohur me letemjeftimin personal,i cili deklaroi,se ka nenshkruar me vullnet te lire kete statut dhe une e vertetoj rregullisht.

N O T E R I

ILIR DUSHI

PULLE TAKSE

50 LEKE

R.SHQIPERISE